



Prishtinë, 24 mars 2010  
Kodi i ZRRE-së: V\_230\_2010

## **Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Duke marrë parasysh:

- Nenin 15.2 dhe Nenin 47 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080;
- Rregullën mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike (Rregulla e Çmimeve);
- Metodologjinë e Tarifave për Sektorin e Energjisë Elektrike; dhe
- Kërkesën e KOSTT SH.A. për Shqyrtimin e tarifave të transmisionit, të datës 8 shkurt 2010,

**Në mbledhjen e mbajtur me 24 mars 2010 nxori këtë:**

### **VENDIM**

**APROVOHEN** tarifat dhe ngarkesat e transmisionit, që do të zbatohen nga KOSTT SH.A. nga data 1 prill 2010.

### **Arsyetim**

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), me datë 08 shkurt 2010 nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT SH.A) ka pranuar kërkesën për shqyrtimin e tarifave të transmisionit.
2. Për vendosjen e tarifave dhe ngarkesave të transmisionit ZRRE ka pasur parasysh edhe dokumentet e lëshuara dhe të publikuara në ueb faqen e saj:
  - Shqyrtimi i katërt i tarifave të energjisë elektrike 2010 (SHTE4) – Raporti konsultativ lëshuar më 26 shkurt 2010; dhe
  - Shqyrtimi i katërt i tarifave të energjisë elektrike 2010 (SHTE4) – Shqyrtimi i komenteve, përgjigjet dhe propozimet e ZRRE-së, lëshuar më 18 mars 2010.
3. Duke marr parasysh dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të theksuar në hyrje dhe shqyrtimet të të gjitha shkresave dhe dokumenteve relevante, Bordi ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

4. Struktura e tarifave dhe ngarkesave për KOSTT SH.A., që do të zbatohen nga data 1 prill 2010 është si në tabelën e mëposhtme.

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të lidhjes	Elementi Tarifor	Njësia	Aprovuar
Gjenerimi	400kV / 220kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	0.934
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.018
Gjenerimi	110kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	0.934
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.018
Gjenerimi	Distribucioni	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	0.287
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.018
Furnizimi	400kV / 220kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	4.057
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	0.934
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.018
Furnizimi	110kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	8.832
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	0.934
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.018

5. KOSTT SH.A. duhet ta publikojë këtë vendim së paku në një prej gazetave ditore me qarkullim të gjerë në Kosovë, brenda 5 ditësh të punës pas marrjes së vendimit dhe publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së.
6. Vendimi është nxjerrë në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të përkthimeve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
7. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi dhe do të publikohet në faqen elektronike të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Dr. Ali Hamiti, kryesues

\_\_\_\_\_  
Theranda Beqiri, anëtare

\_\_\_\_\_  
Përparim Kabashi, anëtar

\_\_\_\_\_  
Blerim Koci, anëtar